

FJALA E DEPUTETIT FATIION VEIZAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Është e vërtetë që ne këtu jemi për të përfaqësuar interesat e zgjedhësve tanë, por është shumë e rëndë, faktikisht solidarizohem, të intimidohet një deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Në momentin që intimidohet një deputet i Kuvendit të Shqipërisë mendoni se çfarë mund t'i ndodhë një qytetari të thjeshtë. Kjo është në vazhden e thellimit të autokracisë, të mohimit të të drejtave, luftës kundër shtypit, kundër zërit të lirë dhe kundër çdo lloj opozitarizmi që ka në këtë vend.

Gjatë debatit publik që u bë në lidhje me situatën energjetike u thanë disa të pavërteta. E kërkova fjalën për të ndërhyrë, nuk m'u dha, sepse më thanë kur ta marrësh fjalën mund të flasësh për këtë çështje.

Dua të bëj vetëm një pyetje: sa është kostoja mesatare e ponderuar e çmimit të energjisë që normalisht ky shtet e blen nga KESH-i, nga prodhuesit privat dhe nga tregu ndërkombëtar? Në fakt, ky çmim për 3-mujorin e parë është 11,3 lekë. Po ashtu, këtu u tha që qeveria shqiptare me taksat tona u paguan familjeve shqiptare 4 herë më tepër se shuma që ata do të paguajnë për faturën e tyre. Në qoftë se ata, siç u soll edhe një shembull këtu, paguajnë 5 mijë lekë në muaj, pra 50 mijë lekë të vjetër në muaj, ndërkohë që fatura reale është 200 mijë lekë, kjo nuk është fare e vërtetë dhe për fat të mirë këtë e përgënjeshtroi gjatë fjalës së saj kolegja Bushka, duke thënë se vetëm 30% e energjisë që ne konsumojmë importohet. Çmimi nuk është ai 30%-ëshi që blihet në bursë, por është çmimi i mesatares së ponderuar të çmimit që blihet.

Ajo që unë doja të flisja sot ka të bëjë me faktin se prej datës 17 tetor universitetet publike janë përfshirë në një grevë pa afat me efekt të menjëhershëm dhe më të rëndësishmin, bojkotimin e plotë të procesit mësimor, i parashikuar të niste këtë ditë. A ishte kjo një rrufe në qiell të hapur, një pabesi apo një thikë pas shpine ndaj qeverisë, siç e ka akuzuar Kryeministri trupën pedagogjike, një kapriçio e tyre apo është diçka më serioze dhe krejtësisht legjitime?

Pak kronologji.

Në datën 30 gusht të këtij viti nga ana e sindikatës së pavarur të universiteteve shqiptare në drejtim të Kryeministrit, ministres së Arsimit, si dhe rektorëve të universiteteve publike shqiptare është drejtuar një petition, i cili përmban 9 kërkesa, ku midis tyre janë: rritja e pagave; rritja e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor e me radhë deri te transparenca e plotë lidhur me shpenzimet e kryera nga universitetet. Heshtje e plotë, madje jo neglizhimi, por refuzimi në heshtje përmes injorimit u shoqërua me disa protesta paralajmëruese 1-orëshe gjatë muajve shtator-tetor derisa u arrit në përshkallëzimin e datës 17 tetor.

Pse? Nuk mund t'i jepet përgjigjja pse-së apo më saktë pse-ve të shumta pa theksuar disa prej arsyeve që gradualisht çuan deri këtu. Si kudo, edhe në arsimin e lartë procesi ushtrohet, rregullohet dhe monitorohet përmes kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore. Në krye të kësaj kornize qëndron ligji nr. 80 i

vitit 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Është komentuar pa fund ky ligj i hartuar dhe i miratuar në mënyrë krejtësisht të njëanshme nga maxhoranca pas 2013-ës, por më e keqja pa e marrë fare në konsideratë edhe rezistencën e fortë (kjo edhe nëpër komisionet parlamentare) të pedagogëve dhe të studentëve. Nuk e kuptuan dot apo mos e njihnin situatën më pak dhe më keq sesa ministri i radhës i kohës?

Sipas jush po, por ama ky ligj ishte benzina që ushqeu zjarrin e protestave më të mëdha që ka njohur kryeqyteti që prej dhjetorit '90. Se si e përballuat këtë zjarr, e tregojnë më mirë se gjithçka lëvizjet e pakontrolluara të Kryeministrit në njërin prej televizioneve kombëtare në një studio të mbushur me patronazhistë. Edhe prej paaftësisë sonë, pra të opozitës, ju arritët të shpëtoni përkohësisht nga ky zjarr (me sa duket keni mësuar nga gabimi që është bërë në dhjetor të '90-ës). Pse?

Së pari, duke qenë i shkruar keq, madje shumë keq, ai nuk arrin të bëhet i zbatueshëm. Cila është prova? Nuk ka asnjë ligj tjetër në këtë vend që të ketë nevojë për hartimin e një numri aq të madh aktesh nënligjore, si VKM, urdhra ministri, udhëzime e të tjera, sesa ky. Paaftësia totale për hartimin e tyre, të cilat edhe kur miratoheshin, më shumë e ngatërronin punën sesa e zgjidhnin atë, shoqërohet edhe me faktin që praktikisht e rrënuat autonominë universitare të garantuar nga Kushtetuta, duke e bërë universitetin me dy koka akademike dhe administrative. Sot universitetet nuk janë më njësi didaktike, kërkimore dhe shkencore, por njësi administrative. Pse? Sepse me këtë ligj ju u keni dhënë autoritet fuqiptotë vendimmarrës përfaqësueseve tuaj të qeverisë, të emëruar pa asnjë kriter merite nëpër bordet e administrimit, ku përveç Universitetit të Tiranës, ata janë shumicë. Kjo ka çuar në situatën që në universitetin e dytë më të madh në vend, vitin e shkuar të mos miratohej buxheti deri në muajin tetor, muaji i dhjetë i vitit. Absurdi shkon edhe më tej kur këto borde i japin vetes të drejtë të kontrollojnë edhe punën e akademikëve. Një pyetje kam: këta juristë, gazetarë, ekonomistë, agronomë, veterinerë a e kanë ekspertizën e mjaftueshme të njohin specifikat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpër universitete, ku i ka çuar partia? Sa për argument, po ju kujtoj që i pari juaj vjet e pranoi vetë që ky ligj duhej rishikuar.

Megjithatë, nuk u mjaftuat vetëm me ligjin, por nxorët disa vendime të qeverisë, përmes të cilave filluat të mbyllnit vit pas viti rubinetet që do të ushqenin auditorët me studentë. Rifutët edhe një herë tjetër në lojë mesataren. Pretendoni që reformën e keni anglo-saksone, por nuk keni dhënë asnjë rast të universiteteve të këtij lloji që e aplikojnë mesataren e shkollës së mesme si kriter përjashtues. Mos ngatërroni qëllimisht sistemin preferencë-meritë me atë përjashtues. Kjo do të çonte pashmangërisht aty ku arritëm sivjet, ku vetëm 2 ndër 3 maturantë aplikuan për t'u regjistruar nëpër universitetet publike shqiptare. Aktualisht janë plotësuar më pak se gjysma e kuotave të miratuara në to, duke rrezikuar shumë seriozisht mbylljen përfundimtare jo më të diplomave të ciklit të parë, as të fakulteteve, por tani të universiteteve të tëra, kryesisht të rretheve, por nuk janë më pak të rrezikuara edhe disa prej tyre në Tiranë.

Pedagogët kërkojnë rritje rroge. Po pse? Sepse që në vitin 2012, se atë të parashikuar për vitin 2013 e shfuqizuat bashkë me shpërblimin qesharak të dhënë nga qeverisja jonë prej 10,000 mijë lekësh vit, keni bërë vetëm një rritje të tyre – atë me VKM-në numër 268, datë 29.03.2017 në masën 10%. Aty parashihnit rritjen në të njëjtën masë edhe të tarifës së orëve suplementare, por e ujdiset përmes udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” të ministrit të MASR-së, i cili konsideroi se leksioni në baçelor është po njëlloj si ai në master apo edhe më tej, në doktoratë. Këto të fundit treguat kujdes të posaçëm që t'i mbyllni (ju thoshit t'i bllokoni, por, në fakt, i mbyllët) për 9 vjet. Për të qenë i saktë, lejuat për nja dy universitete private,

kuptohet ato që ishin më afër partisë, paçka se të gjithë bëjnë reklama me pedagogët e universiteteve publike.

Ju e dini, por nuk ju pëlqen ta pranoni se edhe në gjysmën tonë, në Kosovë, pedagogët paguhen saktësisht me paga nga 1,27 deri në 1,67 herë më të larta. Edhe nëse i krahasojmë me pagat e premtuara prej VKM-në numër 647, datë 05.10.2022, që vetëm aritmetika juaj mund të gjejë zgjidhjen, pasi edhe sot universitetet pagat e dy muajve i paguajnë nga të ardhurat e tyre dytësore, tani do të duhet të paguajnë edhe një pagë të tretë, atë 8%-shin tjetër që është 96%/vit, sërish do të mbeten 1,11 deri në 1,45 herë më të vogla, sipas kategorive përkatëse.

Edhe më e keqe është situata për stafet ndihmës-akademike. Në 9 vjet qeverisjeje pagat janë rritur vetëm 17,7% se 8% edhe nëse e japin universitetet. Besoj se nuk do t'i bini gjoksit që po e jepni ju, a thua se i nxirrni nga llogaritë tuaja këto para. Inflacioni kumulativ për këto vite është rreth 33%, ai progresiv mbi 42%, hesapin bëjeni vetë dhe po i referohem INSTAT, se ai realisht është ku e ku më i lartë.

Universitetet e kanë thujtë të pamundur të përfitojnë ndonjë qindarkë nga punët publike ose me saktë qokat që ju u bëni "analfabetëve funksionalë" që ju shërbejnë me besnikëri.

Çfarë synoni kështu? As më shumë dhe as më pak sesa detyrimin e universiteteve që t'i rrisin tarifat dhe t'i shtrydhin edhe më shumë studentët, apo më saktë familjet e tyre, apo ndoshta me duart e universiteteve hakmerreni ndaj rehatit të prishur të shefit, por realisht i godisni deri në palcë të dyja palët.

Në Kosovë, qeveria e këtij vendi të varfër i kompenson studentet për çdo muaj me 100 dollarë. Ju, që keni sufiçit prej gjysmë miliardi euro deri tani zero. Ju lutem, i lini mënjane ato dokrrat e energjisë elektrike, pasi çmimi i ponderuar i saj për këtë vit është më pak se 11,3 lekë. Pedagogët kërkojnë rritje të financimit për kërkimin shkencor. Qeverisja jonë organizoi dhe financoi në tetë vjet programet: për kërkim kombëtar dhe zhvillim; për kërkim fundamental dhe ekselencë; cilësi dhe barazi në arsimin e lartë.

Universitetet e mbështetura me grante qeveritare arrinin të financonin (edhe pse me shifra modeste) programin për kërkim dhe zhvillim.

Qeverisja juaj, ka financuar vetëm tri programe për kërkim kombëtar dhe zhvillim. Sivjet është vënë tavan prej 2,500, lekë, projekt dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila e reduktoi shumën e projekteve fitues në vetëm 60% të saj. Se si mund të bëhet shkencë pa para, vetëm ju mund te na e thoni.

Si gjithmonë arroganca dhe autoritarizmi nuk mungojnë edhe në këtë rast, pasi, në kundërshtim me nenin 57 të Kushtetutës, pikës 3, nenin 73, pikave 5 dhe 6, nenin 76 të ligjit tuaj të shkatërrimit të arsimit të lartë, kërcënoni se nuk do t'ua jepni diplomat studentëve, fillimisht të mjekësisë dhe më pas të tjerëve. Nuk dua ta besoj që është nostalgji për kohët e errëta të demaskimit të atyre që "janë mosmirënjohës ndaj popullit që i ka bërë mjekë, inxhinierë, juristë" apo edhe të rikthimit të klonit. Por mos harroni është puna dhe mendja e tyre, bashkë me sakrificat e tejskajshme të familjeve të tyre që u mundësojnë shkollimin. Ju jo vetëm nuk keni asnjë meritë, përkundrazi u krijoni vetë pengesa.